

Ndihma e një avokati për çështjet e shëndetit mendor

Ju keni të drejtë të merrni ndihmë nga një avokat i pavarur për çështjet e shëndetit mendor nëse e dëshironi këtë gjë. Këta avokatë janë të pavarur nga personat që merren me çështjet e përkujdesjes ndaj jush.

Ata mund t'ju ndihmojnë që të informoheni rreth përkujdesjes dhe trajtimit që merrni, rreth arsyes pse jeni të shtruar në spital, rreth asaj se çfarë do të thotë kjo dhe rreth të drejtave tuaja. Ata mund t'ju vizitojnë dhe mund t'ju ndihmojnë që të kuptoni atë që ju kanë thënë personat që merren me përkujdesjen dhe me trajtimin tuaj. Nëse dëshironi, ata mund t'ju ndihmojnë të flisni me këta persona ose mund të flasin vetë me ta në emrin tuaj. Gjithashtu, ata mund t'ju ndihmojnë në gjykatë.

Ju mund të kontaktoni vetë me shërbimin e pavarur të mbështetjes për çështjet e shëndetit mendor.

Duhet të ekzistojë një telefon nëpërmjet të cilit të mund të kontaktoni shërbimin e mbështetjes dhe të flisni me ta privatisht. Mund të pyesni një pjesëtar të stafit për vendndodhjen e këtij telefoni.

Numri i telefonit për shërbimin e mbështetjes është: